



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 1047/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Burim Ademi Kryesues, Zyhdi Haziri dhe Ferki Xhaferi anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e Sabit Istogu, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Skenderaj, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, dega në Skenderaj, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur me datë 07.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET i pabazuar apeli Anr.1047/2021 i datës 04.11.2021 i parashtruar nga Sabit Istogu, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Skenderaj, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, dega në Skenderaj, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal në vendvotimet 2124/01R, 2124b/02D 2134b/01D, 2105b/01R, 2105b/02R, 2105b/03R dhe 2105b/04D.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 04.11.2021, nga Sabit Istogu, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Skenderaj, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, dega në Skenderaj, me të cilën pretendon se në vendvotimet 2124/01R, 2124b/02D 2134b/01D, 2105b/01R, 2105b/02R, 2105b/03R dhe 2105b/04D, e kanë votuar të afërmit dhe miqtë e tij, mirëpo këto vota i mungojnë në rezultatet përfundimtare. Më tej thekson se është dëmtuar për 30 vota nga rezultatet e KQZ-së.

Parashtruesi i apelit nuk ka bashkangjitur asnjë provë, si dëshmi lidhur me pretendimet në apel.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të besueshmërisë së apelit dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

Paneli, vlerësoi se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar asnjë dëshmi lidhur me shkeljet e supozuara lidhur me mungesën e votave të tij dhe

pasqyrimin jo të drejtë të rezultateve edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret, paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur mos përfshirje apo mungesë të votave të parashtruesit të apelit, për faktin se thëniet e tij nuk mbështeten në asnjë provë konkrete por janë të përgjithshme e jo të konkretizuara, sepse pritjet e ankuesit për të marrë më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka mos përfshirje të saktë votave në rezultate përfundimtare, andaj pala ankuese nuk i ka argumentuar shkeljet e pretenduara në apel.

Si përfundim, Paneli vlerësoi se apeli i parashtruar nga Sabit Istogu, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Skenderaj, nga subjekti politik LVV, dega në Skenderaj, nuk është bazuar në asnjë dëshmi bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë regjistrimit të votave për kandidat, dhe si i tillë apeli vlerësohet si i pa bazuar.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli parashtruar nga Sabit Istogu, nga subjekti politik PDK, nuk është i bazuar me asnjë dëshmi ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje apo parregullsi gjatë numërimit të votave.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.1047/2021 më datën 07.11.2021



Kryesuese e Panelit
Burrim Ademi

***Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.*